




Published on *Istituto Comprensivo Monterotondo Via B. Buozzi 18* (<https://www.istitutobuozzimonterotondo.edu.it>)

---



**MONTEROTONDO**





Monterotondo gjendet ne qender te rajonit Lazio dhe ne pjesen qendrore te

Italise.

Eshte distant nga Roma 30 km. dhe eshte i ndare ne:

- Monterotondo Alto
- Monterotondo Scalo.

Monterotondo eshte i karakterizuar nga kodra, qe nuk kalojne lartesine 150 mt., me vreshta e ullishte. Pershkohet nga lumi Tevere. Klima eshte e bute, me dimra jo shume te ftohte e verera jo shume te nxehta.

Ne Monterotondo ka shume dyqane e sherbime, per shembull:

- Zyra postare;
- Disa supermerkate;
- Disa furra buke;
- Disa ristorante;
- Biblioteka

Tani do vizitojme Duomo, Palazzo Orsini, harkun e San Rocco dhe Piazza Leoni, e me pas do flasim per festat dhe per recetat tipike te Monterotondos.

## **MONUMENTET**

### **Duomo**



Ne vitin 1621, “keshilli i te 40-teve”, vendosi te ndertonte nje kishë te re ne Monterotondo qe do perfshinte kishen e vjeter e te vogel te ndertuar pese shekuj me perpara. Familjes Barberini ju desh te pranonte vendimin e Keshillit. Per kete arsye vendosi nje kryq ne vendin ku do te ndertohej kisha e re qe u ndertua me 1630. Meqenese kishin zgjeruar muret mbrojtese te qytetit me perpara, nuk kishin leke te mjaftueshme per te dekoruar fasaden e kishes, kjo eshte arsyeja per te cilen ajo ka nje pampje te perparshme shume te thjeshte.

Ne vitin 1641 papa Urbano VIII vizitoi duomo te cilit i dhuroi nje fasade te shenje e nje kampane te madhe.

Ne vitin 1845 papa i ri Gregorio XVI e beri kishen Basilica Minore.

Brenda harkut ne kishë ndodhet nje pikturë e madhe e Shen Merise e bere nga Domenico Pistrini. Gjithashtu gjendet edhe nje statujë prej druri e Shen Merise me Femijen. Altari eshte nje varr antik i shekullit te II pas Krishtit.

## Palazzo Orsini





**PALAZZO ORSINI**  
di Marino  
L'edificio è stato costruito nel 1530 per ospitare la sede del Tribunale di Marino. È stato progettato dall'architetto romano Bramante. L'edificio è stato restaurato nel 1980. È stato dichiarato Monumento Nazionale nel 1938. È stato restaurato nel 1980. È stato dichiarato Monumento Nazionale nel 1938. È stato restaurato nel 1980. È stato dichiarato Monumento Nazionale nel 1938.



v e qe paraqesin simbolin e familjes Grillo. Ne pallat jane te pranishme edhe stema te papeve, te famijes Medici e Orsini. Sallat e brendshme jane dekoruar me afreske te periudhes se Rilindjes. Oborri i brendshem quhet “oborri i pusit”, sepse ne mes gjendet nje pus i ndertuar ne shekullin XVI nga nje artist roman. Pas termetit te Avezzano ne 1915 u rindertua. Nga viti 1890 pallati eshte qender e zyrave administrative te qytetit.



Ndertuar nga arkitekti Frontoni ne

1722, ishte pjese e mureve qe mbyllnit qytetin; eshte e fundit e kater portave hyrese ne qender te qytetit. Kjo porte eshte nje monument nacional i njohur si “porta romane” para vitit 1870 dhe e quajtur “porta Garibaldi” pas fitores se Garibaldit. Per te hyre ne qytet, duke ardhur nga lugina e Tevere, Garibaldit ju desh ti vinte zjarr portes qe ndalonte hyrjen ne qytet.

Mbi porten jave vendosur dy flamure, flamuri Italian dhe ai European.

Garibaldi: Giuseppe Garibaldi (Nizza, Korrik 1807 – Caprera, Qershor 1882) ishte nje gjeneral e patriot. Eshte nje nga personazhet historik me te njohur italian, i njohur ne gjithe boten, dhe eshte nje hero nacional.

Fontana dei Leoni





Shatervani i Luaneve ndodhet ne piazza e Luaneve dhe eshte ndertuar ne 1845 nga kardinal Lambruschini si simbol i



Piazza dei Leoni ndodhet ne pjesen

antike te Monterotondos. Ne origjine sheshi quhej Piazza del Popolo. Me vone sheshi mori emrin Piazza dei Leoni sepse ne qender eshte nje skulpture me kater luane.

Ne shesh ndodhen edhe disa dyqane, nje restorant, nje bar dhe nje librari. Ngjitur me sheshin eshte edhe nje ndertese ku Garibaldi i foli popullit.

**Via Cavour**



Lidh Duomo me sheshin e luaneve. Ndodhet ne qender te Monterotondos dhe eshte e pasur me dyqane te ndryshem: gjenden disa kafenera, dyqane veshje, parukeri, nje dyqan ushqimor, nje dyqan peshku e nje dyqan mishi.

## Il Giardino del Cigno

Perballe Komunes se Monterotondos gjendet Kopshti i Mjellmave. Ne kopsht gjenden disa rrugi



ca per shetitje e disa lojra per femijet. Kopshti eshte i rrethuar nga gardh e peme te larta. Ne qender gjendet nje shatervan, shatervani i Mjellmes, i quajtur keshtu sepse karakterizohet nga nje statuje qe paraqet nje burre qe mban nje mjellme nga sqepi i te ciles del uje. Ne kopsht gjendet edhe nje monument per te renet ne Luften Boterore.



n 17 Janar eshte festa e Shen Antonios. Shen Antonio es

hte patroni i kafsheve dhe neper rruget e Monterotondos behen

sfilata kuajsh e lulesh prej robe. Ne mengjes besimtares sjellin kuajt perpara duomo. Ne mbremje behet shetitja me pishtar: ecet neper rruget e Monterotondos, ku njerezit mbajne nje pishtar e veshin nje kapele te kuqe e te zeze. Shetitja e

Pishtarit zgjat pothuajse dy ore e mbaron perpara shtepise se zotit te ri qe u ofron te gjitha atyre qe kane marre pjese ne festa e "mulattieri". Zoti i ri duhet te lere



Antonio.

Me 24 qershor eshte festa e Ciummacates. Perpara sheshit te duomo, popullata mblidhet per te degjuar muzike e per te kercyer. Pjata tipike eshte me baze kermillash. Ne mesnate digjet nje shtrige, simbol i ardhjes se veres.



Bruno Buozzi ka lindur me 31 Janar 1881 dhe eshte vrare

nga ushtaret gjermane ne Rome me 4 Qershor 1944. Gjate periudhes fashiste, B.Buozzi ka qene nje sindakalist i rendesishem. Kur Roma u pushtua nga ushtaret gjerman, B.Buozzi u perpoq te fshihej ne shume vende, po ne fund u kap nga nazistet. Ai u burgos ne qershor 1944 dhe me pas u vra me te burgosurit e tjere ne "La Storta", afer Romes. Pas vdekjes se tij, shume rruge, sheshe e shkolla moren emrin Bruno Buozzi ne gjithe Italine.

## RECETAT



Perberesit:

- 1 kg. miell;
- 33 cl vere e bardhe;
- 3 luge kripe;
- 3 luge uzo.

### Procedura:

Ngrohni veren me uzon. Perzjeni te gjithe perberesit deri sa te beni nje perberje te bute. Ndani brumin ne 9 pjese te barabarta, beni format e petullave dhe verini te ziejne. Lerini te thahen per rreth 90 min, pastaj piqini ne furre per rreth 60 min.



Perberesit:

- 2 veze;
- 200 g sheqer;
- 1 gote vere e bardhe;
- maja;
- lekura e nje limoni;
- 400 g miell;
- lajthi

Procedura:

Rihni sheqerin me vezet. Shtoni miellin dhe perberesit e tjere e formoni nje brum te bute. Beni brumin ne copa dhe verini ne furre per rreth 20 min. Hiqni nga furra dhe priteni brumin ne copa te vogla. Vini te gjithë prape ne furre per 15 min te tjera. Lerini te ftohen mbi nje zgarre.

---

**URL Sorgente (modified on 17/06/2014 - 23:14):**

<https://www.istitutobuozzimonterotondo.edu.it/monterotondo-alb>